



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 675/1 prot.

Tiranë, më 29. 04. 2026

V E N D I M

Nr. 111, datë 29. 04. 2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 82 Regj., datë 08.04.2026, të M. S., kundër shoqërisë “Tech and Smile Provider” shpk, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore dhe çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, M. S., evidentohen pretendimet e tij kundrejt subjektit për të cilin pretendon se e ka diskriminuar, shoqërisë “Tech and Smile Provider” shpk, ku, ndër të tjera, shprehet se: “Gjatë trajtimit tim dentar në tetor 2025, më është marrë një mostër gjaku për një procedurë të planifikuar për zmadhimin e kockave. Klinika e përdori pikërisht këtë mostër gjaku, pa dijeninë time, pa asnjë njoftim paraprak, pa një formular pëlqimi dhe pa lejen time, për të kryer një test të shpejtë HIV.

Ndërsa isha ulur në karrigen dentare dhe në procesin e nxjerrjes së dhëmbëve, klinika papritmas më njoftoi se rezultati i testit kishte dalë pozitiv, Si rezultat, trajtimi u ndërpre menjëherë. Më pas u dërgova në një laborator fqinj, ku më është kërkuar të paguaj nga xhepi im për një test konfirmues.

Stafi më trajtoi në një mënyrë shumë akuzuese. Në asnjë moment nuk më është ofruar ndonjë mbështetje psikologjike ose këshillim. Pas testit, i cili ishte kryer pa dijeninë time, më është faturuar gjithashtu 1,000 euro për “sterilizim special”; për më tepër, takimet pasuese u anuluan me arsyetimin se dyshohet se kisha kontaminuar të gjithë dhomën, duke bërë kështu të nevojshme “dekontaminimin e specializuar”. Megjithatë, si mjek vetë, e di që masa të tilla

¹ Ankuesi ka referuar për shkak të statusit të perceptuar të HIV-it.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

nuk janë të nevojshme nga ana mjekësore. Ashtu siç është rasti në Gjermani, nuk ka ligj që detyron dikë të zbulojë statusin e tij HIV në një klinikë ose para çdo procedure mjekësore, pikërisht për të parandaluar diskriminimin. Kjo vlen me forcë të veçantë kur, si në rastin tim dikush ka mbajtur një ngarkesë virale të pazbulueshme për 15 vjet. Më 6 mars 2026, nënshkrova dhe dërgova një marrëveshje në lidhje me ndërprerjen e trajtimit dhe një rimbursim, në të cilën klinika u zotua të rimbursonte 3,750 €. Nuk i mora këto fonde deri më 30 mars 2026, vonë, dhe vetëm pas kërkesave të shumta nga ana ime dhe një deklarate ndërmjetëse nga ana ime se marrëveshja ishte 'e pavlefshme'.

Nuk e nënshkrova kurrë formularin e pëlqimit të përgjithshëm për të gjithë trajtimin dentar, pasi më kërkoi të konfirmoja se nuk kisha pyetje të mëtejshme dhe se dentisti më kishte shpjeguar të gjithë procedurën e trajtimit. Meqenëse, në atë kohë, nuk kisha folur ende me asnjë mjek, pavarësisht nga specialiteti i tyre mjekësor deklarova se do ta nënshkruaja formularin vetëm pas konsultës mjekësore. Megjithatë, ky konsultim nuk u zhvillua kurrë; si pasojë, nga pikëpamja ligjore, nuk ka absolutisht asnjë deklaratë të vlefshme pëlqimi në dosje për ndonjë formë trajtimi mjekësor.

Ndërsa isha shtrirë i qetësuar në karrigen e trajtimit dhe dhëmbët në nofullën e poshtme po më nxirreshin, një grindje po zhvillohej në një cep të dhomës. Të gjithë të pranishmit, me përjashtimin tim, ishin të përfshirë në këtë diskutim; në përfundim të tij, më informuan se isha HIV-pozitiv dhe se trajtimi duhej të ndërpritej, pa marrë protezat e mia të reja dentare. Edhe pse ata vendosën transplantin e kockave, më pas më thirrën në një dhomë të veçantë ku mbajtën një lloj "grykate" dhe deklaruan se do të duhej të anulonin të gjitha takimet e mëtejshme (gjë që, megjithatë, nuk e bënë). Për më tepër, më ngarkuan një tarifë prej 1,000 € për masa të veçanta sterilizimi (nëse do ta kisha zbuluar infeksionin tim HIV paraprakisht, kostot do të kishin arritur në vetëm 500 €)".

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri të marrë masa për: *"Hetim zyrtar të klinikës, sanksione të përshtatshme dhe mbështetje për marrjen e kompensimit të plotë prej të paktën 10,000 eurosh"*.

Pas regjistrimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin provues lidhur me masat që kërkonte nga Komisioneri, si dhe provueshmërinë e pretendimeve të tij.

Për këtë arsye, nëpërmjet e-mailit datë 10.04.2026, nga ana e KMD-së, ankuesit i është bërë e ditur që, meqenëse aktet e depozituara ishin në gjuhën gjermane apo angleze dhe jo në gjuhë shqipe, (të cilat lidhen drejtpërdrejtë me provueshmërinë e pretendimeve të tij, në kontekst edhe të shkakut të diskriminimit), se aktet duhet të depozitohen në formën e kërkuar nga ligji, të përkthyer në gjuhën shqipe, nga një përkthyes i certifikuar.

Në vijim, subjekti ankues nuk depozitoi aktet provuese në formën e kërkuar nga ligji.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, përcaktohet se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike,*

fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon shkaqet e mbrojtura, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike. Ai është mjaftuar vetëm me faktin që është perceptuar me HIV.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, për sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “shkak të gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ato nuk janë “shkaqet” në vetvete.

Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë, të padrejtë e të pafavorshëm të tij nga ana e shoqërisë “Tech and Smile Provide” shpk, vijnë për shkaqet e pretenduara, duhet që fillimisht këto shkaqe të jetë të provuara e dokumentuara para KMD-së, si shkaqe të njohura nga LMD.

Ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar nga shoqëria “Tech and Smile Provide” shpk, për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”, me arsyetimin se pasi përfaqësuesit e klinikës kanë zbuluar statusin e tij HIV, kanë ndërprerë trajtimin dentar të tij, si dhe nuk i kanë dhënë rimbursimin e plotë financiar.

Lidhur me këtë pretendim të tij ka depozituar disa e-maile të printuara dhe fatura, të cilat janë në gjuhën angleze dhe gjermane. Dhe, për të cilat, pavarësisht se iu kërkua të plotësohej si e metë e të sillëshin në formën e kërkuar nga ligji, M. S. nuk i depozitoi pranë KMD-së, deri aktualisht.

Komisioneri vlerëson se, nëse shkresa është e papërkthyer, ajo nuk mund të vlerësohet si provë me vlerë juridike nga organi administrativ, pasi administrata publike funksionon në gjuhën zyrtare (shqip), vetëm përkthimi nga një përkthyes i licencuar është garanci e vërtetësisë dhe saktësisë së përmbajtjes së aktit, për të pasur fuqi provuese. Gjithashtu, për të garantuar një proces të drejtë e të rregullt ligjor, dokumentet duhet të jenë të kuptueshme dhe në formën e kërkuar nga ligji, për organin që vendos.

Kodi i procedurës civile, i ndryshuar, parashikon se:

Neni 246 - Fuqia provuese e shkresave

“Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen.”

Neni 266 - Shkresa në gjuhë të huaj

“Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent...”

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, e-mail-et dhe faturat e depozituara në formën e paraqitur nga ankuesi, nuk mund të konsiderohen si prova, pasi një shkresë në gjuhë të huaj, vetëm e përkthyer nga një përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë (MD) konsiderohet si provë dokumentuese zyrtare.

Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson të paprovuara në prova e fakte, pretendimin lidhur me provueshmërinë e shkaqeve kundrejt shoqërisë “Tech and Smile Provide” shpk, klasifikuar si “gjendja shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh³. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁴.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”⁵*

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të

³ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”*

⁴ Neni 14, I KEDNJ-së: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.*

⁵ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

tjetër, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*.

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim.

Subjekti ankues nuk ka arritur të provojë, faktojë apo dokumentojë⁶ shkaqet e pretenduara si “gjendja shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”, në mënyrë që të mund të hetohet më tej, nëse trajtimi i pretenduar të kishte ardhur apo të ishte motivuar e nxitur pikërisht për këto shkaqe.

Pra, në analizë të sa më lart, Komisioneri vëren se ka mungesë të theksuar të elementëve të provueshmërisë të shkaqeve të cilësuar nga ana e palës ankuese. Vetëm pasi subjekti ankues të provonte para KMD-së se mbart e posedon shkaqet e pretenduara, atëherë Komisioneri mund të vihej në lëvizje për të kërkuar informacion lidhur me veprimet apo mosveprimet e pretenduara të shoqërisë “Tech and Smile Provide” shpk, karshi tij.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim⁷”*, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj⁸.

⁶ Edhe pas kërkesave të përsëritura nëpërmjet e-mailit, të KMD-së.

⁷ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 205, datë 19.10.2023, Vendimin nr. 226, datë 06.11.2023, Vendimi nr. 27, datë 23.01.2024, Vendimi nr. 41, datë 13.02.2024, të KMD-së etj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr. 82 Regj., datë 08.04.2026, të M. S., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shëndetësore dhe perceptimi me HIV/AIDS)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)